



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 7057/16 Prot.

Tiranë, më 23.12.2025

Lënda: Dërgim i raportit përfundimtar të auditimit

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Nga data 11.11.2025 deri më 14.11.2025, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, e Ministrisë së Arsimit, ka zhvilluar një mision auditimi tematik në zbatim të urdhrit nr.575, datë 10.11.2025, të Ministrit të Arsimit “Për verifikimin e çështjes të paraqitur në shkresën nr.3202 prot., datë 04.11.2025, dërguar në Ministrinë e Arsimit nga Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës”. Bashkëlidhur, ju dërgojmë “Raportin përfundimtar të auditimit”.

Në zbatim të procedurave ligjore për auditimin e brendshëm, ju kujtojmë se:

- Brenda 30 ditëve, nga marrja e “Raportit përfundimtar”, drejtuesi i Universitetit Politeknik të Tiranës duhet të miratojë “Plan-Veprimin” për zbatimin e rekomandimeve, sipas sugjerimeve të paraqitura në projekt raport, të cilin duhet ta dërgoni të nënshkruar në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit.
- Nëse, institucioni i audituar nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin e “Plan veprimit” dhe masat për zbatimin e rekomandimeve, atëherë drejtuesi i NjAB-së informon Ministrin se drejtuesi dhe institucioni i audituar nuk kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet e Universitetit Politeknik të Tiranës, për të na ndihmuar që të vlerësojmë performancën e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë, duke plotësuar aneksin nr.2 “Reagim nga subjekti i audituar” bashkëlidhur, të cilin duhet ta dërgoni në Drejtorinë e Auditimit.

Duke ju falënderuar,

MINISTRI
Mirela Kumbaro Furxhi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR

MBI

VERIFIKIMIN E ÇËSHTJES TË PARAQITUR NË SHKRESËN NR.3202 PROT., DATË
04.11.2025, DËRGUAR NË MINISTRINË E ARSIMIT NGA REKTORI I
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

I. Përmbledhje ekzekutive:

Bazuar në urdhrin nr.575, datë 10.11.2025, të Ministrit të Arsimit “Për verifikimin e çështjes të paraqitur në shkresën nr.3202 prot., datë 04.11.2025, dërguar në Ministrinë e Arsimit nga Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës”, grupi i auditimit kreu verifikimet, nga data 11.11.2025 deri më datën 14.11.2025.

Misioni i auditimit:

Të sigurojë një vlerësim të pavarur, objektiv dhe të bazuar në dokumente mbi respektimin e procedurave ligjore dhe rregullatore nga Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), në lidhje me krijimin, miratimin dhe funksionimin e strukturës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me të Tretë, si dhe me procesin e rekrutimit dhe menaxhimit të personelit të saj.

Objektivat e auditimit tematik kanë qenë:

- Verifikimi i zbatimit të procedurave ligjore për ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Marrëdhënieve me të Tretë, në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Statutin e UPT-së dhe aktet/nënaktet ligjore në fuqi;
- Vlerësimi i përputhshmërisë me legjislacionin e punës lidhur me procesin e rekrutimit të stafit të kësaj drejtorie, lidhjen e kontratave individuale të punës, si dhe mënyrën e funksionimit të saj;
- Evidentimi i mangësive në proceset vendimmarrëse dhe administrative, që mund të çenojnë ligjshmërinë e strukturës ose efektivitetin e veprimtarisë së saj;
- Propozimi i rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm administrativ dhe vendimmarrjes institucionale.

Periudha e audituar: Për qëllime të auditimit, periudha e mbuluar nga verifikimet përfshin dokumentacionin dhe vendimmarrjet e zhvilluara gjatë viteve 2019-2025, të cilat lidhen drejtpërdrejt me ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Marrëdhënieve me të Tretë.

Auditimi u krye: Nga data 11.11.2025 deri më datën 14.11.2025.

Auditimi u realizua, sipas drejtimeve të përcaktuara në Urdhrin nr.575 prot., datë 10.11.2025.

Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve:

- Lidhur me krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe miratimin e Rregullores së disiplinimit të shërbimeve, u konstatuan parregullsi në zbatimin e procedurave ligjore dhe statutore.
- Nga UPT, nuk ishin kryer procedurat e rekrutimit të stafit, të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe për rrjedhojë mungonte dokumentacioni përkatës, duke pamundësuar kryerjen e vlerësimeve të auditimit.
- Lidhja e kontratave me afat të caktuar, për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe mos garantimi i mundësive të barabarta për punësim me afat të pacaktuar, janë jo në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës.
- Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, ishte miratuar nga Bordi i Administrimit (BA), pa një analizë funksionale, studim nevojë, apo argumentim, që të justifikojë numrin e propozuar të punonjësve, në raport me volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që drejtoria duhet të ofrojë.
- Drejtoria e Shërbimeve ndaj të Tretëve, që nga krijimi i saj e deri në momentin e auditimit, ka funksionuar me staf të paplotësuar.

Rekomandime për mangësi të konstatuara:

Rekomandim nr.1: Të rishikohet ligjshmëria e vendimeve të Bordit të Administrimit për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm për rikonfirmimin e saj në përputhje me ligjin dhe statutin.

Rekomandim nr.1.1: Të ndiqen procedurat e rregullta për miratimin e strukturave, duke përfshirë propozimin nga Senati Akademik dhe miratimin nga BA, referuar përcaktimeve në aktet/nënaktet ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.1.2: Të rishikohet procedura e miratimit të rregullores së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të miratohet, sipas kompetencës ligjore.

Rekomandim nr.1.3: Të rishikohen dhe harmonizohen procedurat e miratimit të strukturave dhe të personelit në universitet, duke garantuar që çdo vendim mbi ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve të mbështetet në propozime të miratuara nga Senati Akademik, në përputhje me ndarjen e kompetencave ligjore ndërmjet organeve drejtuese, për të minimizuar riskun lidhur me ligjshmërinë e vendimeve.

Rekomandim nr.1.4: Të forcohen procedurat e funksionimit të Bordit të Administrimit dhe të sigurohet administrimi i duhur dokumentar i vendimeve dhe procesverbaleve, duke respektuar rregullat për rendin e ditës, pjesëmarrjen, votimin, nënshkrimin e procesverbaleve dhe kërkesat e Rregullores së Bordit të Administrimit.

Rekomandim nr.2: UPT, të sigurojë që procesi i punësimit të personelit administrativ të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, duke organizuar konkurs publik të hapur dhe transparent, në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe me kriteret e punësimit të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit.

Rekomandim nr.2.1: UPT, të hartojë dhe zbatojë procedura të brendshme të qarta dhe të detajuara, të cilat sigurojnë transparencë dhe dokumentim të plotë të çdo hapi të procesit të rekrutimit, që të përfshijnë përcaktim të qartë të përgjegjësive, afateve, hapave të konkurrimit dhe mënyrës së publikimit, duke minimizuar çdo mundësi për paqartësi apo subjektivitet.

Rekomandim nr.2.2: UPT, të hartojë dokumentacionin zyrtar të plotë për të gjitha fazat e rekrutimit dhe për çdo pozicion pune, të cilin ta protokollojë dhe arkivojë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Rekomandim nr.2.3: Të fuqizohet funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e rekrutimeve, duke rritur mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e strukturave përkatëse, si dhe duke kryer

kontrolle dhe auditime të rregullta për të siguruar përputhjen me kuadrin ligjor dhe procedurat e brendshme.

Rekomandim nr.3: Të ndërpritet përdorimi i kontratave me afat të caktuar për pozicione të përhershme pune dhe të sigurohet që të gjitha kontratat për këto pozicione pune të lidhen me afat të pacaktuar, në përputhje me kërkesat në Kodin e Punës.

Rekomandim nr.3.1: Të zbatohen procedura të qarta dhe transparente, për njoftimin e punonjësve me kontrata me afat të caktuar, mbi vendet e lira të punës dhe për krijimin e mundësive të barabarta për punësim në punë me afat të pacaktuar.

Rekomandim nr.3.2: Të sigurohet që lidhja e kontratave me afat të caktuar të bëhet vetëm kur ekzistojnë arsye objektive që justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës, sipas kërkesave të Kodit të Punës, dhe çdo rast i tillë të dokumentohet në mënyrë të qartë.

Rekomandim nr.4: UPT, të kryejë një analizë funksionale të plotë të nevojave të drejtorisë, duke u bazuar në volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që ofron, me qëllim përcaktimin real të numrit optimal të punonjësve. Në vijim, të rishikohet organika, bazuar në nevojat e konstatuara, si dhe të sigurohet plotësimi i stafit sipas strukturës së rishikuar.

Rekomandim nr.5: UPT, të kryejë një analizë të plotë të situatës lidhur me mangësitë e konstatuara në krijimin, funksionimin dhe administrimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, duke identifikuar qartë shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësitë institucionale. Në vijim, të ndërmerren masat e nevojshme, sipas kompetencave ligjore, për korrigjimin e parregullsive të konstatuara dhe për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, me qëllim parandalimin e përsëritjes së praktikave të ngjashme në të ardhmen.

Opinion mbi tematikën e audituar është se nga verifikimi i dokumentacionit janë konstatuar veprime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore në fuqi, trajtuar në raport. Mbështetur në germën 'e', të nenit 16, të Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Kapitulli IV, pikat 4.1.11 dhe pika 4.1.12, për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të UPT, si dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes së veprimeve që nuk janë në përputhje me aktet ligjore, kemi lënë rekomandimet përkatëse.

II. Hyrje

Misioni i auditimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, u zhvillua mbështetur në Ligjin nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar, në urdhrin nr.575, datë 10.11.2025, të Ministrit "Për verifikimin e çështjes të paraqitur në shkresën nr.3202 prot., datë 04.11.2025, dërguar në Ministrinë e Arsimit nga Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës".

Në zbatim të urdhrin të Ministrit të Arsimit, grupi i auditimit zhvilloi takim me drejtuesit e UPT-së, të përfaqësuar nga Rektori z.Akli Fundo, Zëvendës Rektoren znj.Elfrida Shehu dhe Administratori z.Besmir Ali.

Grupi i auditimit kërkoi gjithë dokumentacionin shkresor/elektronik për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në zbatim të urdhrin, që lidhen me:

- a. Zbatimin e procedurave ligjore nga Universiteti Politeknik i Tiranës, që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e strukturës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me të tretë;
- b. Përputhshmërinë me legjislacionin lidhur me rekrutimin e stafit, lidhjen e kontratave individuale të punës dhe funksionimin e kësaj strukture.

Baza ligjore:

- Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Manuali i auditimit të brendshëm, i ndryshuar;
- Ligji nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Statuti i UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Rregullorja për funksionimin e Bordit të Administrimit të UPT-së;
- Si dhe çdo akt tjetër ligjor që lidhet me tematikën e auditimit.

Arsyet për auditim janë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm për tematikën e përcaktuar në urdhrin nr.575, datë 10.11.2025, si dhe dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme nivelit të lartë të menaxhimit nëse sistemet e kontrollit kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në njësinë e audituar.

Misioni i Auditimit u realizua nga grupi i auditimit i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, i përbërë nga Isa Neza dhe Ilirjana Çina, në zbatim të urdhrin nr.575 prot., datë 10.11.2025, të lartpërmendur.

Auditimi u krye nga data 10.11.2025 deri me datë 14.11.2025.

III. Metodatat e auditimit të përdorura gjatë kryerjes së auditimit, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat kanë si qëllim marrjen e informacionit të detajuar dhe të mjaftueshëm nga personat e autorizuar, janë:

a. *“intervistimi”*, biseda me drejtues të UPT-së, për të kuptuar praktikën reale të tematikës objekt auditimi dhe përputhshmërinë me legjislacionin..

b. *“Testimi hap pas hapi”*, që përfaqëson ndjekjen brenda sistemit të transaksioneve specifike nga fillimi deri në fund, për të parë se si njësi publike i përmbahet procedurave të caktuara.

c. *Testimi i detajuar*, që përfshin ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, e cila na jep evidenca më të besueshme se sa intervistimi dhe e përdorim pasi kemi planifikuar që të marrin të dhëna nga të gjithë transaksionet (ose nga një shembull për transaksion) në një grupim.

Teknikat e auditimit të përdorura janë:

i. *Përzgjedhja me gjykim*, që kërkon një vlerësim profesional, është më efiçente dhe ekonomike e përdoret ku madhësia e përzgjedhjeve është e vogël ose aty ku nuk pritet që rastësia të na japë përzgjedhje që mund të përfaqësojnë masën, tërësinë e proceseve a transaksioneve;

ii. *Shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve*, përputhshmëria me aktet/nënaktet ligjore, rregulloret dhe dokumentacionin e brendshëm për të verifikuar nëse janë respektuar procedurat për krijimin dhe funksionimin e kësaj strukture.

Në përfundim të angazhimit të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të dokumenteve dhe shpjegimeve të personave të subjektit të audituar, u përgatitet projekt-raporti i auditimit, i cili me shkresën nr.7057/3, datë 04.12.2025, i është dërguar UPT-së, në të cilin janë sugjeruar rekomandimet, për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në të ardhmen.

Administratori i UPT-së, me shkresën nr.3295/1 prot., datë 19.12.2025, protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr. 7057/5, datë 22.12.2025, ka dërguar kundërshtimet për projekt raportin. Gjithashtu, me shkresën e protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr.7057/4, datë 19.12.2025, znj. Mirela Bimo, në cilësinë e anëtares së Bordit të Administrimit ka dërguar observacionet për projekt raportin.

Grupi i auditimit shqyrtoi kundërshtimet/observacionet e paraqitura, rezultatet e të cilave janë pasqyruar në Aneksin nr. 2 “Observacionet” të këtij raporti. Bazuar në Manualin e Auditimit të

Brendshëm, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i planit të veprimit nga njësia e audituar”, dërgohet raporti përfundimtar i auditimit dhe pritet nga subjekti i audituar paraqitja e planit të veprimit të plotësuar.

IV. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, sipas drejtimeve të auditimit të miratuara në Urdhrin nr.575, datë 10.11.2025, paraqiten si më poshtë:

a. Zbatimi i procedurave ligjore nga Universiteti Politeknik i Tiranës, për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me të Tretë.

Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e procedurave ligjore nga Universiteti Politeknik i Tiranës, për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së Drejtorisë së Marrëdhënieve me të Tretë, rezultoi se:

Senati i UPT-së, me vendimin nr.17, datë 24.07.2019 “Për miratimin e strukturës së Përgjithshme të Universitetit Politeknik të Tiranës”, ka miratuar sipas pikës 1, strukturën e përgjithshme të UPT-së, ndërsa sipas pikës 2, të vendimit, i ka propozuar Bordit të Administrimit numrin e personelit të UPT-së, në të gjitha nivelet. Vendimi i Senatit Akademik, i lartpërmendur dhe struktura e UPT-së, e miratuar, i është dërguar Bordit të Administrimit, me shkresën nr.1486 prot., datë 11.10.2019, ndërsa relacioni për strukturën, i është dërguar me shkresën nr.1486/1 prot., datë 11.10.2019. Në këtë strukturë **nuk rezulton të jetë propozuar nga Senati Akademik krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve.**

Administratori i UPT-së, me shkresën nr.123/2, datë 22.01.2020 “Mbi krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve”, drejtuar Bordit të Administrimit është shprehur mbi domosdoshmërinë e krijimit sa më të shpejtë të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, me qëllim realizimin në kohë të shërbimeve për palët e interesuara.

Bordi i Administrimit, me vendimin nr.3, datë 23.01.2020 (i nënshkruar nga 4 anëtarë, nga shtatë gjithsej që përbëhet bordi), protokolluar me nr.36/2, datë 23.01.2020, ka vendosur të **miratojë krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve**, si një strukturë e posaçme e cila do të ndjekë të gjitha procedurat e koordinimit, menaxhimit dhe monitorimit të shërbimeve ndaj të tretëve, sipas propozimit të Administratorit të institucionit.

Gjithashtu, BA, me vendimin nr.5, datë 23.01.2020 (i nënshkruar vetëm nga kryetari i BA), protokolluar me nr.36/4, datë 23.01.2020, ka vendosur sipas pikës 1, të miratojë numrin e përgjithshëm të personelit në UPT-së, për të gjitha nivelet, ndërsa sipas pikës 2, të këtij vendimi, ka miratuar që “Në numrin e përgjithshëm të personelit të UPT-së, shtohet edhe personeli i drejtorisë së krijuar për shërbimet ndaj të tretëve”.

Referuar dokumentacionit lidhur me mbledhjen e BA-së, të datës 23.01.2020, si: e-mail datë 22.01.2020, drejtuar kryetarit dhe anëtarëve të BA-së dhe proces verbalit të zhvillimit të mbledhjes të kësaj date, rezulton se në çështjet e adresuara për rendin e ditës nuk është përfshirë shtimi i numrit të personelit për drejtorinë e shërbimit ndaj të tretëve, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e paracaktuara në “Rregulloren për funksionimin e BA, të UPT-së”, nenin 9 ‘Zhvillimi i mbledhjeve’, pika 2, ku citohet: “Rendi i ditës së mbledhjeve të Bordit vendoset nga kryetari. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar Bordit nga anëtarët e organit kolegjal dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për të përfshirë një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet më shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen. Rendi i ditës duhet t’i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes”. Sipas procesverbalit të mbledhjes rezulton të kenë marrë pjesë në mbledhje 5 anëtarë gjithsej nga 7, që përbëhet BA, ndërkohë që procesverbali është nënshkruar vetëm nga 3 anëtarë dhe vendimi është i nënshkruar vetëm nga kryetari i BA. Nuk ka një dokument tjetër që të konfirmojë votimin me 2/3 të anëtarëve të BA, për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit lidhur me miratimin e numrit të personelit të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, duke vepruar jo në

përputhje me përcaktimet në Rregulloren për funksionimin e BA, të UPT-së”, nenin 13 ‘Marrja e vendimeve’, pika 1, ku citohet: *“Bordi merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës atëherë”*. Po ashtu në procesverbalin e mbledhjes nuk janë cilësuar vendimet që u morën, duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet në Rregulloren për funksionimin e BA, të UPT-së”, nenin 15 ‘Procesverbali i mbledhjes’, pika 1, ku citohet: *“Në çdo mbledhje mbahet një proces-verbal, ku bëhet një përmbledhje e problematikës së mbledhjes, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve”*.

Rektorati me shkresën nr.1438 prot., datë 25.11.2020, drejtuar Administratorit dhe për dijeni Bordit të Administrimit, ka kërkuar informacion lidhur me bazën mbi të cilën BA, ka marrë vendimin për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, pasi nuk është njohur në rrugë zyrtare me këtë vendim dhe as nuk është në dijeni të propozimit të Administratorit. Administratori me shkresën nr.1438/1 prot., datë 11.12.2020, i ka kthyer përgjigje Rektorit dhe për dijeni ia ka dërguar edhe BA.

Senati Akademik, me shkresën nr.1522 prot., datë 07.12.2020, drejtuar kryetarit të BA-së, ka kërkuar që të rishikohet përputhshmëria ligjore e vendimeve të BA-së nr.3, datë 23.01.2020, nr.4, datë 23.01.2020 (*çështjet e miratuara dhe të trajtuara në këtë shkresë i përkasin vendimeve nr.3 dhe nr.5, datë 23.01.2020*) dhe nr.15, datë 24.04.2020, të UPT-së, për të cilën nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje.

Konstatohet se ngritja e kësaj drejtorie dhe shtimi i numrit të personelit të saj nga BA, janë bërë pa propozimin e Senatit Akademik, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, germa ‘ç’, ku citohet: *“Harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”*, me kërkesat e Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 9, pika 3 “Funksionet kryesore të SAUPT”, germa ‘c’, ku citohet: *“Harton strukturën e përgjithshme të UPT në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore të tij dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”*.

Sa më sipër, procesi i miratimit të strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe i numrit të personelit të saj, nuk është bërë sipas procedurave ligjore, pasi procesi nuk është ndjekur në mënyrë të dokumentuar, ku të përfshinte: propozimin/et, shqyrtimin/et përkatëse, miratimin nga Senati Akademik dhe propozimin drejtuar Bordit të Administrimit.

Gjithashtu, konstatohet se Administratori, me shkresën nr.153/1 prot., datë 21.04.2020, drejtuar BA-së, është shprehur mbi domosdoshmërinë e shqyrtimit dhe miratimit sa më të shpejtë të “Rregullores së disiplinimit të sistemit të shërbimeve”, të cilën BA, e ka miratuar me vendimin nr.15, datë 24.04.2020.

Veprimet lidhur me rregulloren e kësaj strukture, janë jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, germa ‘d’, ku citohet: *“miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut”*, me kërkesat e Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 9, pika 3 “Funksionet kryesore të SAUPT”, germa ‘i’, ku citohet: *“miraton rregulloret e UPT-s dhe akteve e tjera institucionale”*.

Vendimet e BA, të lartpërmendura, të administruara në arkivën e institucionit janë të pa sigluara nga sekretari i BA, **duke vepruar jo në** përputhje me përcaktimet në Rregulloren për funksionimin e BA, të UPT-së”, nenin 16 ‘Zbardhja e vendimeve’, ku citohet: “Vendimet e Bordit të Administrimit, zbardhen nga sekretari, jo më vonë se dy ditë nga përfundimi i mbledhjes. Ato hartohen në tre kopje, të cilat nënshkruhen nga Kryetari dhe marrin vulën e Bordit të Administrimit. **Kopja e sigluar nga sekretaria, administrohet në arkivën e institucionit, ndërsa dy kopjet e tjera, njëra ruhet në dosjen përkatëse të sekretarisë së Bordit dhe tjetra subjektit që i adresohet”.**

Sa më sipër, krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, shtimi i personelit dhe miratimi i Rregullores së disiplinimit të shërbimeve, janë kryer jo në përputhje me kuadrin ligjor dhe statutor të UPT-së, duke cënuar ligjshmërinë e vendimeve, legjitimitetin e strukturës dhe rritur riskun ligjor dhe administrativ për institucionin.

Titulli i gjetjes: Mos zbatimi i procedurave ligjore dhe statutore në krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe miratimin e Rregullores së disiplinimit të shërbimeve.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Universiteti Politeknik i Tiranës;
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Organet dhe autoritetet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës; Ministria e Arsimit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Statuti i UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Rregullorja për funksionimin e BA, të UPT-së.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga verifikimi i dokumentacionit lidhur me zbatimin e procedurave ligjore për ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve në Universitetin Politeknik të Tiranës, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bordi i Administrimit, me vendimin nr.3, datë 23.01.2020, miratoi krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, pa pasur propozimin e detyrueshëm nga Senati Akademik, siç parashikohet në Ligjin nr.80/2015 dhe në Statutin e UPT-së. - Vendimi nr.5, datë 23.01.2020, për shtimin e numrit të përgjithshëm të personelit, si pasojë e shtimit të numrit të kësaj drejtorie, është marrë jashtë rendit të ditës dhe pa respektuar kërkesat për votimin me 2/3 e anëtarëve të Bordit. - Procesverbali i mbledhjes së BA, nuk pasqyron vendimet e marra dhe është nënshkruar vetëm nga 3 prej 5 anëtarëve pjesëmarrës, ndërsa vendimet janë firmosur vetëm nga Kryetari i BA-së. - Vendimet përkatëse të BA-së, të protokolluara, nuk janë sigluar nga sekretari i Bordit, në kundërshtim me nenin 16, të Rregullores për funksionimin e BA-së. - Rregullorja e disiplinimit të shërbimeve ndaj të tretëve është miratuar nga BA (vendimi nr.15, datë 24.04.2020), ndonëse miratimi i rregulloreve është kompetencë e Senatit Akademik. <p>Procesi i miratimit të strukturës, të numrit të personelit dhe miratimi i rregullores nuk janë kryer në përputhje me kërkesat ligjore dhe statutore.</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, germa “ç” dhe “d”, Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, neni 9, pika 3, germa “c” dhe “i” dhe me kërkesat e Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të UPT-së, nenet 9, 13, 15 dhe 16, të saj.</p>

	<p>Ndikimi/Efekti: Kryerja e procedurës së miratimit të strukturës, shtimit të numrit të personelit dhe miratimit të rregullores së disiplinimit të shërbimeve ndaj të tretëve, pa ndjekur rrugët e përcaktuara ligjërish:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ka cënuar apo mund të cënojë parimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet organeve drejtuese të universitetit; - Ka krijuar rrisht lidhur me vlefshmërinë ligjore të vendimeve për ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve; - Ka sjellë apo mund të sjellë pasoja në aspektin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare, duke krijuar mundësi për shpenzime të pambështetura në vendime të ligjshme; - Situata ka krijuar apo mund të krijojë konflikte institucionale midis organeve drejtuese të UPT-së, duke krijuar pasiguri në funksionimin e shërbimeve, si dhe duke rritur mundësinë për vendimmarrje jo të ligjshme dhe të paqarta për personelin e drejtorisë. <p>Shkaku: Mos zbatim i procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën ka ardhur si shkak i:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mos koordinimit institucional midis strukturave menaxhuese të UPT-së; - mos zbatimit të kërkesave të përcaktuara në aktet/nënaktet përkatëse ligjore në fuqi, për miratimin e strukturës organizative e të rregullores së kësaj drejtorie; - mos funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, shtimi i personelit dhe miratimi i Rregullores së disiplinimit të shërbimeve, janë kryer jo në përputhje me kuadrin ligjor dhe statutor të UPT-së, duke cënuar ligjshmërinë e vendimeve, legjitimitetin e strukturës dhe rritur riskun ligjor dhe administrativ për institucionin.
Rekomandimi	<ul style="list-style-type: none"> - Të rishikohet ligjshmëria e vendimeve të Bordit të Administrimit për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm për rikonfirmimin e saj në përputhje me ligjin dhe statutin. - Të ndiqen procedurat e rregullta për miratimin e strukturave, duke përfshirë propozimin nga Senati Akademik dhe miratimin nga BA, referuar përcaktimeve në aktet/nënaktet ligjore në fuqi. - Të rishikohet procedura e miratimit të rregullores së drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të miratohet, sipas kompetencës ligjore. - Të rishikohen dhe harmonizohen procedurat e miratimit të strukturave dhe të personelit në universitet, duke garantuar që çdo vendim mbi ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve të mbështetet në propozime të miratuara nga Senati Akademik, në përputhje me ndarjen e kompetencave ligjore ndërmjet organeve drejtuese, për të minimizuar riskun lidhur me ligjshmërinë e vendimeve. - Të forcohen procedurat e funksionimit të Bordit të Administrimit dhe të sigurohet administrimi i duhur dokumentar i vendimeve dhe procesverbaleve, duke respektuar rregullat për rendin e ditës, pjesëmarrjen, votimin, nënshkrimin e procesverbaleve dhe kërkesat e Rregullores së Bordit të Administrimit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

b. *Përputhshmëria me legjislacionin lidhur me rekrutimin e stafit, lidhjen e kontratave individuale të punës dhe funksionimin e kësaj strukture.*

Rekrutimi i stafit;

Gjatë procesit të auditimit mbi verifikimin e procedurave të rekrutimit të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, grupi i auditimit ka kërkuar dokumentacionin përkatës që mbështet procesin e rekrutimit për periudhën nga krijimi i strukturës, me vendimin e BA të datës 23.01.2020, deri në datën 13.11.2025, duke përfshirë punësimin e parë të kryer më datë 25.05.2020 dhe punësimet e realizuara në periudha të mëvonshme.

Me shkresën nr.3328, datë 13.11.2025, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Universitetin Politeknik të Tiranës, ka informuar grupin e auditimit se nuk disponon dokumentacionin e kërkuar që lidhet me procedurat e rekrutimit të stafit për periudhën e sipërpërmendur, pasi nuk janë zhvilluar këto procedura.

Për shkak të mungesës së këtij dokumentacioni, grupi i auditimit nuk ka mundur të realizojë verifikimet dhe vlerësimin e përputhshmërisë së procedurave të rekrutimit me kërkesat ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Ky fakt përbën një mangësi të rëndësishme në administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar, si dhe pengesë për kryerjen e auditimit në këtë fushë, duke ndikuar në transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale.

Sa më sipër, në kushtet e mungesës së dokumentacionit të procedurave të rekrutimit të stafit të kësaj drejtori, për shkak të mos zhvillimit të tyre, është vepruar jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 3, ku citohet: “*Punësimi i personelit administrativ në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet me konkurs publik. Kriteret e punësimit përcaktohen në statutet dhe rregulloret e brendshme të institucioneve*”.

Veprimet e mësipërme, janë gjithashtu jo në përputhje me përcaktimet në Rregulloren e Administratës së Rektoratit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015, të Rektorit, neni 22 dhe nenin 23 të saj.

Titulli i gjetjes: Moskryerja e procedurave të rekrutimit të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe mungesa e dokumentacionit përkatës, duke pamundësuar kryerjen e vlerësimeve të auditimit.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Universiteti Politeknik i Tiranës;
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Organet dhe autoritetet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës; Ministria e Arsimit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregullorja e Administratës së Rektoratit të UPT, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015.

Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë procesit të auditimit mbi verifikimin e procedurave të rekrutimit të stafit të Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, grupi i auditimit kërkoi dokumentacionin mbështetës për periudhën 2020 deri me 13.11.2025. Me shkresën nr. 3328, datë 13.11.2025, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Universitetin Politeknik të Tiranës, informoi se nuk disponon dokumentacionin e kërkuar, pasi procedurat e rekrutimit nuk janë zhvilluar fare gjatë kësaj periudhe. Për shkak të mungesës së dokumentacionit, grupi i auditimit <i>nuk ka mundur të realizojë verifikimet dhe të vlerësojë përputhshmërinë e procedurave të rekrutimit me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.</i> Kjo situatë përbën mangësi të rëndësishme në aspektin e respektimit të procedurave të punësimit, si dhe krijon pengesë për kryerjen e auditimit në këtë fushë, duke ndikuar në transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale.</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 3, që kërkon zhvillimin e konkursit publik për punësimin e personelit administrativ, si dhe me përcaktimet në Rregulloren e Administratës së Rektoratit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015, të Rektorit, neni 22 dhe neni 23, të cilat përcaktojnë procedurat që duhen ndjekur për rekrutimin dhe dokumentimin zyrtar të procesit të rekrutimit.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mos zbatim i procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën, ka krijuar apo krijon efekte që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryerjen e punësimeve jo sipas kërkesave ligjore dhe jo transparente; - Krijimin e riskut për praktika jo të dokumentuara apo të parregullta; - Kompromentimin e integritetit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore; - Pamundësinë për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të punësimit; - Ekspozimin e institucionit ndaj riskut administrativ dhe ligjor; - Cënimin e transparencës, mundësisë së verifikimit dhe llogaridhënies institucionale. - Krijimin e pengesave për kryerjen e auditimit në këtë fushë. <p>Shkaku: Mos zbatim i procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën ka ardhur si shkak i:</p> <ul style="list-style-type: none"> -mos koordinimit institucional midis strukturave menaxhuese të UPT-së; -mos zbatimit të kërkesave të përcaktuara në aktet/nënaktet përkatëse ligjore në fuqi; -mos mbikëqyrje mbi zbatimin e rregullave të punësimit; -mos funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	<p>UPT, nuk ka zhvilluar procedurat ligjore të rekrutimit për stafin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, duke bërë që të mos prodhohet asnjë dokumentacion mbështetës dhe arkiva institucionale të mos ketë materiale për t’u protokolluar. Kjo situatë përbën mospërputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në pikën 3, të nenit 67, të Ligjit nr. 80/2015 dhe rregulloren e brendshme të UPT, duke cenuar transparencën dhe ligjshmërinë e procesit të punësimit, si dhe ka pamundësuar kryerjen e auditimit për këtë fushë.</p>

Rekomandimi	<ul style="list-style-type: none"> - UPT, të sigurojë që procesi i punësimit të personelit administrativ të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, duke organizuar konkurs publik të hapur dhe transparent, në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe me kriteret e punësimit të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit. - UPT, të hartojë dhe zbatojë procedura të brendshme të qarta dhe të detajuara, të cilat sigurojnë transparencë dhe dokumentim të plotë të çdo hapi të procesit të rekrutimit, që të përfshijnë përcaktim të qartë të përgjegjësive, afateve, hapave të konkurrimit dhe mënyrës së publikimit, duke minimizuar çdo mundësi për paqartësi apo subjektivitet. - UPT, të hartojë dokumentacionin zyrtar të plotë për të gjitha fazat e rekrutimit dhe për çdo pozicion pune, të cilin ta protokollojë dhe arkivojë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. - Të fuqizohet funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e rekrutimeve, duke rritur mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e strukturave përkatëse, si dhe duke kryer kontrole dhe auditime të rregullta për të siguruar përputhjen me kuadrin ligjor dhe procedurat e brendshme.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Lidhja e kontratave individuale të punës;

Nga verifikimi i dokumentacionit për lidhjen e kontratave individuale të punës për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, u konstatua se për periudhën nga krijimi i drejtorisë me vendimin nr. 3, datë 23.01.2020 e në vijim, kontratat e punës janë lidhur dhe rinovuar vazhdimisht me afat të caktuar, ndonëse kjo strukturë ka funksionuar për më shumë se 5 vite dhe kryen veprimtari të përhershme institucionale.

Drejtorja e Shërbimeve ndaj të Tretëve, është strukturë funksionale e qëndrueshme brenda organikës së institucionit të UPT-së. Duke qenë se aktiviteti i saj nuk është i përkohshëm dhe nuk lidhet me projekte të limituara në kohë dhe as me punë apo shërbime me natyrë të përkohshme, prandaj lidhja e kontratave me afat të caktuar nuk justifikohet ligjërisht. Rinovimi i vazhdueshëm i kontratave me afat të caktuar për një periudhë mbi 5-vjeçare përbën praktikë jo ligjore dhe konsiderohet si marrëdhënie pune që duhet të jetë **me afat të pacaktuar**, sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

Nga ana e UPT-së, nuk janë paraqitur arsye objektive që të justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës. Gjithashtu, nuk rezulton që punonjësit me kontratë me afat të caktuar të jenë informuar apo t'u jenë ofruar mundësi të barabarta me punonjësit me kontratë me afat të pacaktuar për t'u punësuar në një punë me afat të pacaktuar, siç kërkon ligji.

Sa mësipërm, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se drejtorja ushtron funksione të qëndrueshme dhe të përhershme, për të cilat kontratat me afat të caktuar nuk justifikohen ligjërisht. Institucioni nuk ka njoftuar punonjësit për vende të lira apo mundësi pune me afat të pacaktuar dhe ka vijuar praktikën e rinovimeve të njëpasnjëshme për periudhë shumëvjeçare, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 2, neni 140 ‘Kohëzgjatja e kontratës së punës’, ku citohet: “2. **Kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës në të cilën punëmarrësi**

do të punësohet. Moszbatimi i kësaj dispozite nuk e çënon vlefshmërinë e kontratës, por sjell përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 202, të këtij Kodi”, si dhe kërkesat e pikës 1, të nenit 149/1 ‘Informimi për vendet e lira të punës dhe mundësinë e punësimit’, ku citohet: “1. Punëdhënësi informon punëmarrësin e punësuar me kontratë me afat të caktuar për vendet e lira të punës dhe i siguron mundësi të barabarta me punëmarrësit e tjerë për t’u punësuar në një punë me afat të pacaktuar”.

Titulli i gjetjes: Lidhja e kontratave me afat të caktuar për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe mos garantimi i mundësive të barabarta për punësim me afat të pacaktuar, janë jo në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës.

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i audituar	Universiteti Politeknik i Tiranës;
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Organet dhe autoritetet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës; Ministria e Arsimit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të lidhjes së kontratave individuale të punës për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, u konstatua se për periudhën nga krijimi i drejtorisë me vendimin nr. 3, datë 23.01.2020 e në vijim, kontratat e punës janë lidhur dhe rinovuar vazhdimisht me afat të caktuar. Megjithëse drejtorja ka funksionuar mbi 5 vite, nuk janë paraqitur arsye objektive që të justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës. Gjithashtu, nuk rezulton që punonjësit me kontratë me afat të caktuar të jenë informuar apo t’u jenë ofruar mundësi të barabarta për aplikim në pozicione me afat të pacaktuar, siç kërkon ligji.</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 2, neni 140 ‘Kohëzgjatja e kontratës së punës’, si dhe kërkesat e pikës 1, të nenit 149/1 ‘Informimi për vendet e lira të punës dhe mundësinë e punësimit’.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mos zbatim i procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën, ka krijuar apo krijon efekte që kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mos respektimin e parimit të barazisë në punësim, duke krijuar mundësi për trajtim të pabarabartë ndërmjet punonjësve me kontratë të përhershme dhe atyre me afat të caktuar. - mundësinë e kontestimeve administrative ose gjyqësore, me risk për detyrime financiare (si konvertim kontratash apo kompensime) dhe cënim të të drejtave të punës. - cënimin e transparencës dhe integritetit të procesit të rekrutimit dhe rrit riskun për vendimmarrje të gabuar në punësime. - ndikimin në moralin e stafit dhe stabilitetin e burimeve njerëzore. <p>Shkaku: Mos zbatim i procedurave dhe rregullave që lidhen me situatën ka ardhur si shkak i:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mos zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës lidhur me përdorimin e kontratave me afat të caktuar; - krijimit të një praktike të vazhdueshme dhe të pambështetur ligjërisht për rinovimin e kontratave me afat të caktuar pa arsye objektive; - mos përmbushjes së detyrimit ligjor nga ana e institucionit, për të informuar punonjësit me kontrata me afat të caktuar mbi vendet e lira

	të punës, duke mos u garantuar atyre mundësi të barabarta për punësim me kontrata me afat të pacaktuar, sipas kërkesave ligjore.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	UPT, ka përdorur në mënyrë të pajustificuar kontrata me afat të caktuar për pozicione pune të përhershme, duke vepruar jo në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës, që përcakton se kontrata lidhet kryesisht me afat të pacaktuar dhe se afati i caktuar lejohet vetëm kur ekzistojnë arsye objektive. Kjo praktikë ka cenuar parimin e dhënies së mundësive të barabarta për punësim, pasi punonjësve me kontrata me afat të caktuar nuk u ka ofruar mundësi të barabarta për tu punësuar në një pozicion pune me kontratë me afat të pacaktuar, duke krijuar risk ligjor e financiar për institucionin.
Rekomandimi	<ul style="list-style-type: none"> - Të ndërpritet përdorimi i kontratave me afat të caktuar për pozicione të përhershme pune dhe të sigurohet që të gjitha kontratat për këto pozicione pune të lidhen me afat të pacaktuar, në përputhje me kërkesat në Kodin e Punës. - Të zbatohen procedura të qarta dhe transparente, për njoftimin e punonjësve me kontrata me afat të caktuar, mbi vendet e lira të punës dhe për krijimin e mundësive të barabarta për punësim në punë me afat të pacaktuar. - Të sigurohet që lidhja e kontratave me afat të caktuar të bëhet vetëm kur ekzistojnë arsye objektive që justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës, sipas kërkesave të Kodit të Punës, dhe çdo rast i tillë të dokumentohet në mënyrë të qartë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Funksionimi i Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve.

Nga verifikimi i të dhënave rezultoi se Administratori i UPT-së, me shkresën nr. 123/2, datë 22.01.2020 “Mbi krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve”, drejtuar Bordit të Administrimit, ka përcaktuar se kjo drejtori duhet të ketë në përbërje 1 drejtor dhe 5 specialistë. Megjithatë, dokumentacioni i administruar **nuk përmban asnjë analizë funksionale, studim nevoje, apo argumentim**, që të justifikojë numrin e propozuar të punonjësve, në raport me volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që drejtorja duhet të ofrojë.

Pavarësisht përcaktimit të organikës me 6 punonjës, për periudhën maj 2020 - nëntor 2025, drejtorja ka funksionuar me staf të reduktuar;

- Për vitet 2020–2024, drejtorja ka funksionuar me 5 punonjës (1 drejtor + 4 specialistë).
- Për vitin 2025 (deri në nëntor), në detyrë ishin 4 punonjës (1 drejtor + 3 specialistë).

Kjo tregon jo vetëm **mungesë stafi**, por edhe **mungesë të përputhshmërisë së organikës së propozuar me nevojat reale**, si dhe pamundësi të UPT-së, për të garantuar funksionimin optimal të kësaj strukture.

Sa më sipër, struktura e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, është miratuar pa një argumentim të plotë funksional mbi numrin e punonjësve që i nevojiten, në raport me volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që drejtorja duhet të ofrojë, ndërsa në praktikë ka funksionuar me staf të reduktuar në raport me organikën. Kjo situatë ka ndikuar apo mund të ndikojë në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ajo duhet të ofrojë. Veprimet janë jo në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në

institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe të Rregullores së Administratës së Rektoratit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015.

Titulli i gjetjes: Miratimi i strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, nga BA, pa analizë funksionale dhe funksionimi me staf të reduktuar.

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i audituar	Universiteti Politeknik i Tiranës;
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	Organet dhe autoritetet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës; Ministria e Arsimit.
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Statuti i UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Rregullorja e Administratës së Rektoratit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Struktura e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, është miratuar me 6 pozicione (1 drejtor dhe 5 specialistë), pa u shoqëruar me analizë funksionale, studim nevoje apo argumentim për përcaktimin e numrit të punonjësve. Për periudhën maj 2020 - nëntor 2025 drejtorja ka funksionuar me staf të reduktuar (5 punonjës deri në vitin 2024 dhe 4 punonjës në vitin 2025), duke mos respektuar organikën e miratuar.</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe të Rregullores së Administratës së Rektoratit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.60, datë 26.06.2015, që lidhen me situatën.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Situata, ka krijuar apo krijon efekte lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - cënimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara ndaj të tretëve; - mbingarkesë pune, vonesa dhe mosrealizim të funksioneve të përcaktuara; - mos argumentimin e numrit të punonjësve, në raport me volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që drejtorja duhet të ofrojë; - arritjen e objektivave të institucionit. <p>Shkaku: Mungesa e analizës funksionale dhe studimit të nevojave të punës, si dhe planifikim jo i plotë e i saktë i burimeve njerëzore dhe vonesa në rekrutime, duke krijuar rrisht për arritjen e objektivave.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm.
Konkluzioni	Struktura e miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve ndaj të Tretëve, nuk është mbështetur në analizë funksionale dhe ka funksionuar me staf të reduktuar, duke rritur rrishtun për mosrealizim të plotë të funksioneve dhe shërbimeve që i janë ngarkuar.

Rekomandimi	UPT, të kryejë një analizë funksionale të plotë të nevojave të drejtorisë, duke u bazuar në volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që ofron, me qëllim përcaktimin real të numrit optimal të punonjësve. Në vijim, të rishikohet organika, bazuar në nevojat e konstatuara, si dhe të sigurohet plotësimi i stafit sipas strukturës së rishikuar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, shprehemi se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Opinion i përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në përfundim të angazhimit të auditimit grupi i auditimit shpreh opinionin e përgjithshëm për auditimin në subjektin e audituar se: Sistemi i Kontrollit të Brendshëm për tematikat e audituara nuk ka funksionuar në mënyrë efektive, referuar mangësive të konstatuara, të kryera jo në përputhje me aktet/nënaktet ligjore në fuqi, të cilat kanë apo mund të kenë ndikim në objektivat e UPT-së dhe për rrjedhojë ka nevojë për marrjen e veprimeve për përmirësime në disa drejtime, referuar problematikave të trajtuara në projekt raport.

Aneksi 1

Përmbledhëse e Rekomandimeve

Nr.	Rekomandimet	Niveli i riskut
1	<p><i>Nr.1:</i> Të rishikohet ligjshmëria e vendimeve të Bordit të Administrimit për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm për rikonfirmimin e saj në përputhje me ligjin dhe statutin.</p> <p><i>Nr.1.1:</i> Të ndiqen procedurat e rregullta për miratimin e strukturave, duke përfshirë propozimin nga Senati Akademik dhe miratimin nga BA, referuar përcaktimeve në aktet/nënaktet ligjore në fuqi.</p> <p><i>Nr.1.2:</i> Të rishikohet procedura e miratimit të rregullores së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe të miratohet, sipas kompetencës ligjore.</p> <p><i>Nr.1.3:</i> Të rishikohen dhe harmonizohen procedurat e miratimit të strukturave dhe të personelit në universitet, duke garantuar që çdo vendim mbi ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve të mbështetet në propozime të miratuara nga Senati Akademik, në përputhje me ndarjen e kompetencave ligjore ndërmjet organeve drejtuese, për të minimizuar riskun lidhur me ligjshmërinë e vendimeve.</p> <p><i>Nr.1.4:</i> Të forcohen procedurat e funksionimit të Bordit të Administrimit dhe të sigurohet administrimi i duhur dokumentar i vendimeve dhe procesverbaleve, duke respektuar rregullat për rendin e ditës, pjesëmarrjen, votimin, nënshkrimin e procesverbaleve dhe kërkesat e Rregullores së Bordit të Administrimit.</p>	I lartë
2	<p><i>Nr.2:</i> UPT, të sigurojë që procesi i punësimit të personelit administrativ të zhvillohet në përputhje me kërkesat ligjore, duke organizuar konkurs publik të hapur dhe transparent, në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe me kriteret e punësimit të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit.</p>	I lartë

	<p><i>Nr.2.1:</i> UPT, të hartojë dhe zbatojë procedura të brendshme të qarta dhe të detajuara, të cilat sigurojnë transparencë dhe dokumentim të plotë të çdo hapi të procesit të rekrutimit, që të përfshijnë përcaktim të qartë të përgjegjësive, afateve, hapave të konkurrimit dhe mënyrës së publikimit, duke minimizuar çdo mundësi për paqartësi apo subjektivitet.</p> <p><i>Nr.2.2:</i> UPT, të hartojë dokumentacionin zyrtar të plotë për të gjitha fazat e rekrutimit dhe për çdo pozicion pune, të cilin ta protokollojë dhe arkivojë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><i>Nr.2.3:</i> Të fuqizohet funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në fushën e rekrutimeve, duke rritur mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e strukturave përkatëse, si dhe duke kryer kontrole dhe auditime të rregullta për të siguruar përputhjen me kuadrin ligjor dhe procedurat e brendshme.</p>	
3	<p><i>Nr.3:</i> Të ndërpritet përdorimi i kontratave me afat të caktuar për pozicione të përhershme pune dhe të sigurohet që të gjitha kontratat për këto pozicione pune të lidhen me afat të pacaktuar, në përputhje me kërkesat në Kodin e Punës.</p> <p><i>Nr.3.1:</i> Të zbatohen procedura të qarta dhe transparente, për njoftimin e punonjësve me kontrata me afat të caktuar, mbi vendet e lira të punës dhe për krijimin e mundësive të barabarta për punësim në punë me afat të pacaktuar.</p> <p><i>Nr.3.2:</i> Të sigurohet që lidhja e kontratave me afat të caktuar të bëhet vetëm kur ekzistojnë arsye objektive që justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës, sipas kërkesave të Kodit të Punës, dhe çdo rast i tillë të dokumentohet në mënyrë të qartë.</p>	I mesëm
4	<p><i>Nr.4:</i> UPT, të kryejë një analizë funksionale të plotë të nevojave të drejtorisë, duke u bazuar në volumin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që ofron, me qëllim përcaktimin real të numrit optimal të punonjësve. Në vijim, të rishikohet organika, bazuar në nevojat e konstatuara, si dhe të sigurohet plotësimi i stafit sipas strukturës së rishikuar.</p>	I mesëm
5	<p><i>Nr.5:</i> UPT, të kryejë një analizë të plotë të situatës lidhur me mangësitë e konstatuara në krijimin, funksionimin dhe administrimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, duke identifikuar qartë shkaqet dhe nxjerrë përgjegjësitë institucionale. Në vijim, të ndërmerren masat e nevojshme, sipas kompetencave ligjore, për korrigjimin e parregullsive të konstatuara dhe për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, me qëllim parandalimin e përsëritjes së praktikave të ngjashme në të ardhmen.</p>	I lartë

Aneksi 2

Observacionet

Me shkresën nr.3295/1 prot., datë 19.12.2025, protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr. 7057/5, datë 22.12.2025, z.Besmir Ali, në cilësinë e Administratorit, ka dërguar kundërshtimet për projekt raportin.

<p>Observacioni i gjetjes nr. 1</p>	<p>Z. Besmir Ali në cilësinë e Administratorit me shkresën e lartpërmendur, ka dërguar kundërshtimet për projekt raportin, ku për gjetjen nr.1 dhe rekomandimin e dhënë shprehet se “..., është i pabazuar dhe si i tillë rekomandimi i dhënë krijon rrisht të lartë për nxitjen e konfliktin e kompetencave, marrjen e vendimeve në tejkalim të funksioneve dhe në kundërshtim me frymën e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë”.</p>
--	--

Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Në shkresë nuk ka paraqitur bashkëlidhur asnjë dokument, si dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor, që të kontestojë trajtimin e bërë nga grupi i auditimit në projekt raport për gjetjen.</p> <p><i>Pretendimet e paraqitura, nuk qëndrojnë për arsytet sa vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Senati Akademik, në vendimin dhe strukturën e UPT të miratuar, dërguar BA me shkresën nr.1486, datë 11.10.2019, nuk rezulton të ketë propozuar krijimin e DSHT; -Rektorati me shkresën nr.1438 prot., datë 25.11.2020, drejtuar Administratorit dhe për dijeni Bordit të Administrimit, ka kërkuar informacion lidhur me bazën mbi të cilën BA, ka marrë vendimin për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, pasi nuk është njohur në rrugë zyrtare me këtë vendim dhe as nuk është në dijeni të propozimit të Administratorit. Administratori me shkresën nr.1438/1 prot., datë 11.12.2020, i ka kthyer përgjigje Rektorit dhe për dijeni ia ka dërguar edhe BA. -Senati Akademik, me shkresën nr.1522 prot., datë 07.12.2020, drejtuar kryetarit të BA-së, ka kërkuar që të rishikohet përputhshmëria ligjore e vendimeve të BA-së nr.3, datë 23.01.2020, nr.4, datë 23.01.2020 (<i>çështjet e miratuara dhe të trajtuara në këtë shkresë i përkasin vendimeve nr.3 dhe nr.5, datë 23.01.2020</i>) dhe nr.15, datë 24.04.2020, të UPT-së, për të cilën nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje. -Hartimi i strukturës së përgjithshme të IAL-së dhe i numrit të personelit të institucionit në të gjitha nivelet, janë kompetencë e Senatit Akademik, sipas kërkesave të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, germa ‘ç’, ku citohet: “Harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet” dhe sipas kërkesave të Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 9, pika 3 “Funksionet kryesore të SAUPT”, germa ‘c’, ku citohet: “Harton strukturën e përgjithshme të UPT në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore të tij dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”; -Grupi i auditimit ka argumentuar në mënyrë ligjore duke cituar edhe referencat përkatëse ligjore që lidhen me gjetjen dhe rekomandimin. <p>Përfundimisht, procesi i miratimit të strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe i numrit të personelit të saj, nuk është bërë sipas procedurave ligjore, pasi procesi nuk është ndjekur në mënyrë të dokumentuar, ku të përfshinte: propozimin/et, shqyrtimin/et përkatëse, miratimin nga Senati Akademik dhe propozimin drejtuar Bordit të Administrimit.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar.
Rishikimi i nivelit të rriskut	Niveli i rriskut mbetet i pandryshuar.
Observacioni i gjetjes nr. 2	Z. Besmir Ali në cilësinë e Administratorit me shkresën e lartpërmendur, për gjetjen nr.2 dhe rekomandimin e dhënë shprehet

	<p>se “..., veprimet janë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar, duke përjashtuar klasifikimin e tyre si gjetje me rrisht të lartë”.</p>
<p>Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen</p>	<p>Në shkresë nuk ka paraqitur bashkëlidhur asnjë dokument, si dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor, që të kontestojë trajtimin e bërë nga grupi i auditimit në projekt raport për gjetjen.</p> <p><i>Pretendimet e paraqitura, nuk qëndrojnë për arsyet sa vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - grupi i auditimit kërkoi dokumentacionin mbështetës për rekrutimin e stafit, të periudhës 2020 deri me 13.11.2025, por me shkresën nr.3328, datë 13.11.2025, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Universitetin Politeknik të Tiranës, është shprehur se nuk disponon dokumentacionin e kërkuar, pasi procedurat e rekrutimit nuk janë zhvilluar fare gjatë kësaj periudhe; - veprimet janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 3, ku citohet: “Punësimi i personelit administrativ në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet me konkurs publik. Kriteret e punësimit përcaktohen në statutet dhe rregulloret e brendshme të institucioneve”; - grupi i auditimit ka argumentuar në mënyrë ligjore duke cituar edhe referencat përkatëse ligjore që lidhen me gjetjen dhe rekomandimin. <p>Përfundimisht kjo situatë përbën mangësi të rëndësishme në aspektin e respektimit të procedurave të punësimit, si dhe ka krijuar pengesë për kryerjen e auditimit në këtë fushë, duke ndikuar në transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale.</p>
<p>Rishikimi i statusit të gjetjes</p>	<p>Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar.</p>
<p>Rishikimi i nivelit të rrishtit</p>	<p>Niveli i rrishtit mbetet i pandryshuar.</p>
<p>Observacioni i gjetjes nr. 3</p>	<p>Z. Besmir Ali në cilësinë e Administratorit me shkresën e lartpërmendur, për gjetjen nr.3 dhe rekomandimin e dhënë shprehet se “..., veprimet e kryera në këtë fushë kanë qenë në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore në fuqi, statutin, objektivat institucionale dhe aktet e BA-së, duke provuar në këtë mënyrë edhe funksionimin e sistemeve të kontrollit”.</p>
<p>Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen</p>	<p>Në shkresë nuk ka paraqitur bashkëlidhur asnjë dokument, si dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor, që të kontestojë trajtimin e bërë nga grupi i auditimit në projekt raport për gjetjen.</p> <p><i>Pretendimet e paraqitura, nuk qëndrojnë për arsyet sa vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk janë dokumentuar dhe paraqitur arsye objektive që të justifikojnë natyrën e përkohshme të detyrës; - janë lidhur në mënyrë të pajustificuar kontrata me afat të caktuar për pozicione pune të përhershme; - veprimet janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 2, neni 140 ‘Kohëzgjatja e kontratës së punës’, ku citohet: “2. Kontrata e punës lidhet për një periudhë të pacaktuar. Lidhja e kontratës së punës për një periudhë të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive, që lidhen me natyrën e përkohshme

	<p><i>të detyrës në të cilën punëmarrësi do të punësohet. Mospbatimi i kësaj dispozite nuk e çënon vlefshmërinë e kontratës, por sjell përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2, të nenit 202, të këtij Kodi”, si dhe kërkesat e pikës 1, të nenit 149/1 ‘Informimi për vendet e lira të punës dhe mundësinë e punësimit’, ku citohet: “1. Punëdhënësi informon punëmarrësin e punësuar me kontratë me afat të caktuar për vendet e lira të punës dhe i siguron mundësi të barabarta me punëmarrësit e tjerë për t’u punësuar në një punë me afat të pacaktuar”.</i></p> <p>- grupi i auditimit ka argumentuar në mënyrë ligjore duke cituar edhe referencat përkatëse ligjore që lidhen me gjetjen dhe rekomandimin;</p> <p>Përfundimisht UPT, ka përdorur kontrata me afat të caktuar për pozicione të përhershme, pa arsye objektive, në kundërshtim me Kodin e Punës, duke çënuar parimin e mundësive të barabarta në punësim dhe duke krijuar risk ligjor dhe financiar për institucionin.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar.
Rishikimi i nivelit të rrishtit	Niveli i rrishtit mbetet i pandryshuar.
Observacioni i gjetjes nr. 4	Z. Besmir Ali në cilësinë e Administratorit me shkresën e lartpërmendur, për gjetjen nr.4 dhe rekomandimin e dhënë shprehet se “..., numri i punonjësve ka ndryshuar dhe ka qenë më i vogël se organika e strukturës, por ky fakt nuk nënkupton se kemi mungesë përputhshmërie me nevojat reale dhe as se mund të ketë ndikuar në realizimin e objektivave të institucionit.
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Në shkresë nuk ka paraqitur bashkëlidhur asnjë dokument, si dhe nuk ka dhënë asnjë argument ligjor, që të kontestojë trajtimin e bërë nga grupi i auditimit në projekt raport për gjetjen.</p> <p>Pretendimet e paraqitura, nuk qëndrojnë për arsyet sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kundërshtimi nuk adreson thelbin e gjetjes, e cila lidhet me miratimin e strukturës pa analizë funksionale të dokumentuar, dhe jo me funksionimin praktik të drejtorisë; - funksionimi me staf më të vogël se organika e miratuar dhe mos ndikimi në realizimin e objektivave të institucionit, konfirmon mungesën e planifikimit dhe analizës paraprake, të miratimit të strukturës; - nuk janë paraqitur evidenca dokumentare që të provojnë kryerjen e një analize funksionale, organizative apo financiare përpara miratimit të strukturës; <p>Përfundimisht, struktura e miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve ndaj të Tretëve, nuk është mbështetur në analizë funksionale dhe ka funksionuar me staf të reduktuar, duke rritur rrishtin për mosrealizim të plotë të funksioneve dhe shërbimeve që i janë ngarkuar.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar.
Rishikimi i nivelit të rrishtit	Niveli i rrishtit mbetet i pandryshuar.

Me shkresën e protokolluar në Ministrinë e Arsimit me nr.7057/4, datë 19.12.2025, znj. Mirela Bimo, në cilësinë e anëtares së Bordit të Administrimit ka dërguar observacionet për projekt raportin.

<p>Observacioni i gjetjes nr. _____</p>	<p>Znj. Mirela Bimo në cilësinë e anëtares së Bordit të Administrimit me shkresën e lartpërmendur, ka dërguar observacionet e pjesëshme që lidhen me krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, për të cilat shprehet se kufizohen vetëm në aspektet proceduriale dhe të vendimmarrjes së Bordit të Administrimit. Në observacion ka ngritur një sërë pretendimesh, si në rastet ku shprehet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “tre nga katër anëtarët që kanë nënshkruar vendimin e krijimit të drejtorisë së shërbimeve janë përfaqësues të Senatit Akademik në Bordin e Administrimit, duke reflektuar edhe vullnetin institucional të Senatit Akademik në këtë proces vendimmarrës”; - “personalisht nuk jam pjesë e vendimmarrjes së aktit e krijimit të DSHT, pasi nuk kam marrë pjesë në mbledhje, por vlerësoj se projekt raporti i auditimit nuk evidenton elementë konkret që të provojë shkelje të Rregullores së Bordit të Administrimit, në kuptim të kuorumit, kompetencës apo formës së vendimmarrjes”; - “vlerësoj se DSHT përbën një strukturë administrative shërbimesh dhe nuk përfshihet në kategorinë e njësive akademike dhe as në strukturën akademike të institucionit në kuptim të neneve 22-24, të ligjit 80/2015”; - “grupi i auditimit nuk është shprehur mbi mënyrën se si do të vlerësohet vlefshmëria e këtyre të ardhurave, nuk ka analizuar pasojat financiare që do të rridhnin nga një pavlefshmëri eventuale e vendimit dhe nuk ka asnjë orientim mbi mënyrën e trajtimit, rikuperimit apo korigjimit të efekteve financiare të prodhuara, duke lënë të pa qartë pozitën financiare të institucionit”; - “grupi i auditimit ka rekomanduar rikonfirmim të DSHT, pa sqaruar mbi bazën e cilës analizë ligjore, institucionale apo financiare mbështetet ky rekomandim...., ” etj.
<p>Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen</p>	<p>Në observacion nuk ka kundërshtuar specifikisht asnjë gjetje dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument apo argument ligjor, që të kontestojë trajtimin e bërë nga grupi i auditimit në projekt raport për tematikën e audituar, përfshirë edhe gjetjet apo rekomandimet e lëna.</p> <p><i>Pretendimet e paraqitura, nuk qëndrojnë për arsytet sa vijon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -Senati Akademik, në vendimin për miratimin e strukturës së UPT, dërguar BA me shkresën nr. 1486, datë 11.10.2019, nuk rezulton të ketë propozuar krijimin e DSHT; -Rektorati me shkresën nr.1438 prot., datë 25.11.2020, drejtuar Administratorit dhe për dijeni Bordit të Administrimit, ka kërkuar informacion lidhur me bazën mbi të cilën BA, ka marrë vendimin për krijimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve, pasi nuk është njohur në rrugë zyrtare me këtë vendim dhe as nuk është në dijeni të propozimit të

	<p>Administratorit. Administratori me shkresën nr.1438/1 prot., datë 11.12.2020, i ka kthyer përgjigje Rektorit dhe për dijeni ia ka dërguar edhe BA.</p> <p>-Senati Akademik, me shkresën nr.1522 prot., datë 07.12.2020, drejtuar kryetarit të BA-së, ka kërkuar që të rishikohet përputhshmëria ligjore e vendimeve të BA-së nr.3, datë 23.01.2020, nr.4, datë 23.01.2020 (<i>çështjet e miratuara dhe të trajtuara në këtë shkresë i përkasin vendimeve nr.3 dhe nr.5, datë 23.01.2020</i>) dhe nr.15, datë 24.04.2020, të UPT-së, për të cilën nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje.</p> <p>-Hartimi i strukturës së përgjithshme të IAL-së dhe i numrit të personelit të institucionit në të gjitha nivelet, janë kompetencë e Senatit Akademik, sipas kërkesave të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, germa ‘ç’, ku citohet: “Harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”, të Statutit të UPT-së, miratuar me urdhrin nr.10, datë 11.01.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 9, pika 3 “Funksionet kryesore të SAUPT”, germa ‘c’, ku citohet: “Harton strukturën e përgjithshme të UPT në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore të tij dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet”;</p> <p>-Përfaqësuesit e Senatit që janë anëtarë të BA, në vendimmarrjet e Bordit nuk do të thotë se kanë reflektuar vullnetin e Senatit Akademik, aq më tepër për rastin konkret, Senati është shprehur se nuk ka dijeni për propozimet administratorit, si dhe me shkresën nr.1542, datë 07.12.2020, ka kërkuar të rishikohet përputhshmëria ligjore të vendimeve të BA;</p> <p>-Grupi i auditimit ka argumentuar në mënyrë ligjore duke cituar edhe referencat përkatëse për tematikën e audituar;</p> <p>-Grupi i auditimit nuk merret me punë apo veprimtari operacionale;</p> <p>-Grupi i auditimit për tematikën objekt auditimi ka dhënë rekomandimet përkatëse, referuar problematikave të trajtuara, të argumentuara nga ana ligjore dhe të bazuara në evidenca të dokumentuara.</p> <p>Përfundimisht, procesi i miratimit të strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve ndaj të Tretëve dhe i numrit të personelit të saj, nuk është bërë sipas procedurave ligjore, pasi procesi nuk është ndjekur në mënyrë të dokumentuar, ku të përfshinte: propozimin/et, shqyrtimin/et përkatëse, miratimin nga Senati Akademik dhe propozimin drejtuar Bordit të Administrimit.</p>
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjeve mbetet i pa ndryshuar.
Rishikimi i nivelit të rrishtut	Niveli i rrishtut mbetet i pandryshuar.

Konkluzion i përgjithshëm

Në përfundim të shqyrtimit të observacioneve dhe kundërshtimeve të paraqitura nga Administratori dhe nga anëtarja e Bordit të Administrimit, grupi i auditimit vlerëson se pretendimet e ngritura nuk shoqërohen me evidenca të dokumentuara dhe as me argumente konkrete ligjore, që vënë në diskutim faktet, kriteret, vlerësimet, gjetjet dhe rekomandimet e trajtuara në raportin e auditimit.


Kundërshtimet e paraqitura janë të karakterit të përgjithshëm, të pambështetura në dokumentacion, pa argumentim ligjor dhe nuk trajtojnë thelbin e gjetjeve të auditimit, i cili konsiston në moszbatimin e procedurave ligjore, mungesën e dokumentimit të procesit vendimmarrës, si dhe mosrespektimin e kompetencave institucionale të përcaktuara në aktet dhe nënaktet ligjore në fuqi.

Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se gjetjet dhe rekomandimet e lëna mbeten të vlefshme, të argumentuara ligjërisht, si dhe të mbështetura në evidenca të dokumentuara, e të verifikuara gjatë procesit të auditimit, duke ruajtur të pandryshuar statusin e gjetjeve dhe nivelin përkatës të riskut.

GRUPI I AUDITIMIT

Isa Neza

Ilirjana Çina



Reagim nga subjekti i audituar

Subjekti i audituar:	Universiteti Politeknik i Tiranës
Angazhimi i auditimit:	Urdhri nr.575, datë 10.11.2025, i Ministrit të Arsimit
Data e raportimit:	më 04.12.2025

Pas përfundimit të angazhimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë, në secilën nga fushat e përmendura.

Shkalla e vlerësimit

(1) – Shumë të kënaqur (2) – Të kënaqur (3) – Të pakënaqur (4) – Shumë të pakënaqur

Nr.	Komponentët e përfomancës (Sa të kënaqur jeni)	1	2	3	4	Komente
I	Planifikimi i Auditimit					
1	Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushe veprimin e auditimit para se të fillonte ?					
2	Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit ?					
II	Kryerja e auditimit					
3	Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes së auditimit ?					
4	Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë suaj ?					
5	A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhimit të auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan ?					
III	Raportimi i rezultateve të auditimit					
6	Projekt raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?					
7	Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur ?					
8	Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?					

9	Rekomandimet afruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuara ?					
10	Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme ?					
IV	Cilësia e auditimit të brendshëm					
11	Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes ?					
12	Auditimi ju afroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë ?					
13	A kontribuon auditimi i brendshëm në përmirësimin dhe arritjen e objektivave strategjike të organizatës Tuaj ?					
V	Shërbime të tjera të ofruara nga auditimi i brendshëm					
14	A jeni të vetëdijshëm se njësi e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi ?					
15	Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë ?					

Ps: Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin “Komente” në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.

Drejtuesi i Institucionit
